



Buletini i Turizmit

Raportim Mujor
Shtator 2018

PËRMBAJTJA

HYRJE

- 1. VIZITORË TË HUAJ TË HYRË PËR MUAJIN SHTATOR 2018..... fq.3**
 - 1.1. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve**
 - 1.2. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**
 - 1.3. Hyrja e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit**

- 2. TURIZMI KULTUROR.....fq.6**

- 3. TURIZMI NATYROR..... fq.7**

1 HYRJET E VIZITORËVE TË HUAJ PËR MUAJIN SHTATOR 2018


Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Shtator 2018, është 1.121.116, krahasuar me Shtator 2017, ky tregues rezulton me rritje 31, 5 %.

Në Shtator 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 664.184. Krahasuar me Shtator 2017, ky numër është rritur me 44, 6 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në nëntëmujorin e 2018 është 5.061.822 duke u rritur me 19,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Periudha	Shtator 2017	Shtator 2018	Rritja (%)	Jan-Shtat 2017	Jan-Shtat 2018	Rritja(%)
Vizitorët e huaj	459,168	664,184	44,6	422,632	5.061,822	19,8

Më poshtë po japim paraqitjen grafike mujore në këtë periudhë nëntë mujore të shtetasve të huaj, që kanë hyrë në Shqipëri, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2017.



1.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Të dhënat për muajin Shtator tregojnë se, nga të gjithë shtetasit e huaj që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, 540,611 janë shtetas të huaj të konsideruar “turistë”, sipas përkufizimit që termi “turist” ka në legjislacionin vendas.

Më poshtë është tabela e vizitorëve të huaj sipas qëllim të vizitës së tyre që deklarojnë në pikat tona kufitare:

Periudha	Shtator 2017	Shtator 2018	Rritja mujore (%)	Janar-Shtator 2017	Janar-Shtator 2018	Rritja progresive %
Gjithsej	459,168	664,184	44,6	4,224,683	5,061,822	19,8
I. Personale	452,634	656,680	45,1	4,172,776	4,999,540	19,8
Pushime	188,634	343,759	82,6	2,094,930	2,485,304	18,6
Vizitë në miq e të afërm	2,927	968	-67,0	15,651	14,304	-8,6
Vizitorë ditorë	74,289	107,550	44,8	239,830	553,337	130,7
Trajtim shëndetësor	61	20	- 67,2	378	171	-54,8
Qëllime fetare	25	69	176,0	487	626	28,5
Vizitorë të tjerë	171.703	188.292	9,7	1.678.931	1.791.345	6,7
Tranzit	15.363	16.023	4,3	142.569	154.453	8,3
II. Biznes dhe profesionale	6.534	7.504	14,8	51.907	62.282	20,0

Burimi INSTAT

Edhe pse muaji Shtator, është muaji që vjen pas sezonit veror, nga të dhënat rezulton se tashmë Shqipëria është një destinacion, që shfrytëzohet nga të huajt për kulturën, ushqimin, klimën që ofron. Siç vihet re nga krahasimi i të dhënave për të njëjtin muaj të vitit pararendës kemi një rritje në masën 82, 6 % të vizitorëve të huaj, që vijojnë të deklarojnë se vijnë për pushime.

Gjithashtu një rritje të konsiderueshme ka pësuar dhe numri i vizitorëve të huaj, që vijnë për arsye biznesi në këto nëntë muajt e 2018. Për këtë tregues ka një rritje prej 20%, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të 2017.

1.3 Hyrja e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit

Gjatë muajit shtator 2018 kanë hyrë gjithsej 1.121.116 duke shënuar një rritje me 26,9%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe në këtë muaj

udhëtimi me mjete tokësore mbetet udhëtimi më i preferuar për vizitorët e huaj dhe shqiptarë.

Në tabelën më poshtë jepet lloji i udhëtimit të shtetasve të huaj dhe shqiptarë, që kanë arritur në pikat tona kufitare, gjatë muajit Shtator 2018, krahasuar kjo me të njëjtin muaj të vitit 2017:

Nr.	Mënyra e udhëtimit	Periudha		
		Shtator 2017	Shtator 2018	Ndryshimi vjetor ne %
1	Me ajër	113,508	132,714	16,9
2	Me det	64,516	81,426	26,2
3	Me tokë	674,719	906,976	34,4

Burimi INSTAT

Në lidhje me raportin e mënyrës së transportit të zgjedhur nga vizitorët e huaj për të hyrë në Shqipëri në muajin Shtator 2018 me numrin në total të vizitorëve të huaj, i shprehur në %, është si më poshtë:

- a. 81 % e të huajve dhe vendasve zgjedhin rrugën tokësore për të hyrë në Shqipëri;
- b. 11,8% e të huajve dhe vendasve hyjnë në kufirin shqiptar në rrugë ajrore;
- c. 7,2 % e hyrjeve bëhet nëpërmjet transportit detar.

1.4 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve

Në Shtator 2018, ndër vendet që ka hyrjet më të larta në Shqipëri janë shtetasit e huaj me nënshtetësi polake, të cilët kanë një rritje prej 94,6% më shumë se shtatori i 2018. Më pas rritjen më të madhe e kanë vizitorët me kombësi gjermane në vlerën prej 50 % krahasuar me muajin Shtator 2017. Vijon rritja edhe nga shtetësit Kosovarë me një rritje prej 66 %. Në nëntëmujorin e 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri janë shtetasit nga Gjermania, Polonia, Kosova e Italia.

Shtetet	Shtator 2017	Shtator 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Shtator 2017	Janar- Shtator 2018	Ndryshimi progresiv (%)
Kosovë	159.731	265.148	66,0	1,503,594	1,846,372	22,8
Maqedoni	56.720	69.755	23,0	510,001	574,578	12,7
Greqi	40.803	45.535	11,6	351,464	378,301	7,6
Itali	28.122	36.102	28,4	294,447	350,767	19,1
Angli	11.135	12.181	9,4	111,418	99,522	-10,7
Mali i zi	37.650	31.525	-16,3	290,259	256,107	-11,8
Poloni	14.765	28.728	94,6	104,143	142,91	37,2
SHBA	7.616	11.964	57,1	84,462	97,699	15,7
Gjermani	13.059	19.587	50,0	101,807	141,053	38,5
Zvicër	3.381	4.117	21,8	49,032	46,779	-4,6

Burimi INSTAT

2. TURIZMI KULTUROR

Gjatë muajit shtator shihet një rritje në masën 33,7 % më shumë vizitorë në Muzetë, Parqet Arkeologjike dhe Kalatë e vendit tonë, krahasuar me shtatorin e 2017. Vetëm në 12 muzetë e vendit tonë, numri i vizitorëve gjatë këtij muaji është rritur në vlerën 30, 8%. Numri i vizitorëve në Kalatë dhe Monumentet e tjera të Kulturës është rritur me një vlerë prej 33.1 %. Gjithashtu rritje ka pësuar dhe numri i vizitorëve që zgjedhin si destinacion kulturor Parqet Kombëtare dhe Arkeologjike, në masën 36 % më shumë se shtatori i një viti më parë.

Më poshtë po japim tabelën e vizitueshmërisë së institucioneve të kulturës në muajin shtator e krahasuar kjo me të njëjtën muaj të vitit 2017.

Nr.	EMËTIMI I INSTITUCIONIT	Vizitorët	
		Shtator 2017	Shtator 2018
1	MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË	6,960	9,172
2	MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS	2,049	3,536
3	MUZEU I PAVARSISË V Lorë	730	768
4	MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUJË	5,799	0
5	MUZEU ETNOGRAFIK, KRUJË	2,750	5,303
6	MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	1,055	1,081
7	MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT	1,043	8,379
8	MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË,	1,390	1,194
9	MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË,	165	124
10	MUZEU ARSIMIT, KORÇË,	1,766	917
11	MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI	1,729	2,585
12	MUZEU K. I PËRGJIMEVE " SHTËPIA ME GJETHE"	1,518	2,205
TOTALI MUZE		26,954	35,264
1	KALAJA BERAT	8,651	15,548
2	KALAJA GJIROKATËR	14,261	15,736
3	KALAJA PORTOPALERMOS	4,710	5,050
4	KALAJA E KANINËS	150	350
5	KALAJA E HIMARËS	630	733
6	AMFITEATRI	2,032	3,654
7	MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE	110	197
8	MANASTIRI I MESOPOTAMIT	440	0
TOTALI KALA E MONUMENTE TE TJERE		30,984	41,268
1	PARKU KOMBËTAR BUTRINT	27,763	34,575
2	PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI	3,212	5,996

3	PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS	350	1,480
4	PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR	9,811	14,592
5	PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË	337	270
6	PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	234	95
7	PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	415	308
8	PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ	204	236
9	PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE	118	138
TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK		42,444	57,690
		100,382	134,222

Burimi Ministria e Kulturës

Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët në Institucionet Kulturore për këtë muaj rezultojn të jenë përfituar 30,086,610 Lek

3. TURIZMI NATYROR

Gjatë muajit Shtator të dhënat nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se në zonat e mbrojtura ka pasur rreth 400,418 vizitorë vendas dhe të huaj.

Nr. i turistëve në total	Shtator 2018
	400,418
Vendas	244,132
Të huaj	156,286

Tab 6. Burimi Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Siç vihet re nga tabela më lartë, numrin më të madh të vizitorëve në Zonat e Mbrojtura janë vizitorët vendas.

Gjatë muajit Shtator, sipas Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të ardhurat, për zonat ku vizitorët paguajnë, llogaritet që është përfituar një vlerë prej 962.750 Lek.